



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Lord Group" Sh.P.K. të datës 01.04.2025 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i rrethojave të varrezave të Komunës së Prishtinës" me nr. të prokurimit 616-25-1830-5-1-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Lord Group" Sh.P.K. të datës 01.04.2025 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i rrethojave të varrezave të Komunës së Prishtinës" me nr. të prokurimit 616-25-1830-5-1-1.
- II. LEJOHET** autoriteti kontraktues që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.
- III. NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi** hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Lord Group" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 01.04.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i rrethojave të varrezave të Komunës së Prishtinës" me nr. të prokurimit 616-25-1830-5-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtresit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtuar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtresit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim: “Kërkesa 12. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Certifikata ISO •Certifikata ISO 45001 2018 – valide •Certifikata ISO 14001 2015– valide •Certifikata ISO 9001 2015 – valide •Certifikata ISO 3834-2-2005 – valide •Certifikata ISO 4063 - 2023– valide •Certifikata ISO 1090-1-2009+A! – valide. Pas shqyrtimit të tyre, kemi vërejtur se disa nga certifikatat ISO të kërkuara nuk janë të domosdoshme për natyrën e punimeve që do të kryhen, konkretisht keto Iso standarde: 1. ISO 3834-2:2005 nuk është më standard i aplikueshëm. Standardi i ri i vlefshëm është ISO 3834-2:2021 dhe si i tillë konsiderojmë se ky Iso standard nuk është i domosdoshëm për këtë projekt pasi që ai kërkohet për kompanitë që kryejnë saldim në procesin e prodhimit dhe jo për neve si Operator që vetëm do të punoj me rrethojat e prodhuara. 2. Certifikata ISO 1090-1-2009+A! –Emërtimi i saktë i standardit është EN 1090-1:2009+A1:2011. Perveq se është shkruar gabimisht në dokumentacionin e tenderit, mendojmë se është edhe i panevojshëm për Operatores Ekonomik pasi që ky standard lidhet me markimin CE të komponentëve të strukturave metalike prej alumini dhe çeliku. Pjesë e procesit të certifikimit sipas këtij standardi është edhe testimi i mostrës në një laborator të akredituar”.

Përmes nenit 10 paragrafit 10.3 të RRPP është përcaktuar se njësia kërkuese ndër të tjera ka përgjegjësinë për të përgatitur detyrën projektuese, projektin, specifikimet teknike, termat e referencës, paramasën dhe parallogarinë. Përmes nenit 11 paragrafit 11.3 të RRPP përcaktohet se zyrtari i prokurimit ndër të tjera në bashkëpunim me njësinë kërkuese i koordinon dokumentet, projektet, specifikimet, termat e referencës, paramasat, parallogaritë dhe vizatimet. Në këtë rast zyrtari përgjegjës i prokurimit i ka falur besimin e plotë përcaktimeve të njësisë kërkuese. Lidhur me pretendimet ankimore, certifikatat ISO janë kërkuar nga AK në përputhje të plotë me LPP (shih nenin 69, 70, et.al. të LPP). Këto certifikata të kërkuara sipas DT, secila prej tyre veçmas dhe të gjitha së bashku, janë absolutisht të domosdoshme për të garantuar standardin e domosdoshëm të cilësisë që nevojitet për të realizuar me sukses kontratën që synohet të lidhet nga ky aktivitet i prokurimit. Prandaj edhe ky pretendim ankimor është i pabazuar në tërësi. Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 08.04.2025

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimi të këtij vendimi.